

1 E premte, 28 maj 2021

2 [Konferencë mbi Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit nuk marrin pjesë]

5 --- Fillon në orën 11.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëmëngjesi të gjithëve në
7 sallën e gjyqit dhe jashtë saj.

8 Zoti i sekretar i gjykatës, ju lutem, paraqisni lëndën.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Kjo është lënda KSC-BC-
10 2020-07, Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinaj.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti
12 sekretar.

13 Tani, do t'u kërkoj palëve që të prezantohen, duke
14 filluar me Zyrën e Prokurorisë së Specializuar.

15 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.
16 Nga Zyra e Prokurorit të Specializuar paraqiten sot, Jack
17 Smith, Prokuror i Specializuar; Matthew Hallin, ndihmës
18 prokuror; James Pace, ndihmës prokuror; Artemis Chatzistavrou,
19 përgjegjëse për nxjerrjen e materialeve dhe unë jam Valeria
20 Bolici, prokurore.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani Mbrojtjes, ju lutem.

22 Z. REES: [Përkthim] Unë jam Jonathan Rees, përfaqësoj z.
23 Gucati dhe ne kemi ardhur sot të gjithë së bashku me Huw
24 Bowden dhe me asistenten tonë, zonjushën Eleanor Stepheson.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Cadman.

1 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] I nderuar
2 Gjykatës, unë jam Toby Cadman për z. Nasim Haradinaj dhe jam
3 së bashku me z. Carl Buckley.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani Zyra Administrative.

5 Z. ROCHE: [Përkthim] Unë jam Ralph Roche, nga Zyra
6 Administrative.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Roche.

8 Tani do të paraqes historinë procedurale të çështjes.

9 Më 20 maj, unë përcaktova datën e konferencës së pestë
10 për statusin e çështjes. Qëllimi im ishte për të organizuar
11 shkëmbime midis palëve për të përgatitur sa më shpejt
12 gjykimin.

13 Dua të diskutojmë sidomos: nxjerrjen e informacionit,
14 marrjen -- pikat e pajtimit në çështjet e ligjit dhe të
15 faktit; gjendjen e hetimeve të mbrojtjes; dhe qasjen në
16 dokumentet në objektin e paraburgimit.

17 Falënderoj Prokurorinë, Mbrojtjen dhe Zyrën
18 Administrative për parashtrimet e tyre dhe nuk ka nevojë që të
19 përsërisni parashtrimet që keni bërë, por mund të trajtoni
20 pikat në mënyrë koncize sipas rendit të ditës.

21 I kujtoj palëve, se duhet të na japin njoftim paraprak në
22 qoftë se në ndonjë nga diskutimet e tyre ato duhet të nxjerrin
23 materiale që janë konfidenciale.

24 Përpara sesa të diskutojmë për çështjet e nxjerrjes së
25 informacionit, dua të filloj sot me pikën e fundit në rendit

1 të ditës, që është çështja e objektit të paraburgimit, që e
2 diskutuam edhe në konferencën e fundit për ecurinë e çështjes.
3 Dua të dëgjojë nga Zyra e Administrative dhe nga palët në
4 lidhje me qasjen në dokumente dhe ndërveprimin midis Mbrojtjes
5 dhe të akuzuarve në objektin e paraburgimit.

6 Në parashtrimin e saj administratorja tha që sistemi i
7 mbrojtur për shkëmbimin e të dhënave ose të dokumenteve apo,
8 siç quhet SEDS, tani funksionon mirë dhe kapaciteti është
9 rritur deri në 100 gigabajt për përdorues. Gjithashtu,
10 administratorja po vlerëson mundësinë që të lejojë dosjet
11 elektronike që të kalojnë midis palëve nga *Legal Workflow* në
12 sistemin elektronik, siç ka kërkuar Mbrojtja, për të lehtësuar
13 komunikimin me të akuzuarit.

14 Dua të falënderoj Zyrën Administrative për të gjithë
15 përpjekjet që ka bërë për të lehtësuar punën e mbrojtësve
16 gjatë kohës së pandemisë.

17 Megjithatë, sipas Mbrojtjes, vazhdojnë të ekzistojnë
18 vështirësi në sigurimin e mundësive të duhura për përgatitje.
19 Pse? Sepse, së pari, Mbrojtja duhet -- do të preferonte të
20 përdorte memorie të bartshme USB për shkëmbimin e
21 informacionit me të akuzuarit; dhe së dyti, komunikimi midis
22 mbrojtësve dhe të akuzuarve ende është i vështirë sepse ata
23 janë të ndarë nga një dritare prej xhami dhe komunikimi bëhet
24 vetëm përmes telefonit. Në lidhje me këtë, vë në dukje, se
25 Haradinaj ka dorëzuar parashtrim në lidhje me këtë, në

1 dokumentin F196.

2 Po kështu, Mbrojtja e Haradinajt ka ngritur edhe çështjen
3 e përkthimit, që është një shqetësim në vijimësi dhe që do të
4 ndikojë nëse do të jemi gati për gjykim apo jo. Për këtë
5 arsye, e ftoj Zyrën e Administrative që të na japë hollësi në
6 lidhje me këto çështje, sidomos nëse parashikohen udhëzime të
7 tjera shëndetësore në kuadrin e zhvillimit të situatës së
8 KOVID-19.

9 Ftoj Zyrën Administrative të na thotë nëse ka zgjidhje më
10 pak kufizuese për komunikimin midis të akuzuarve dhe
11 mbrojtësve të tyre, duke pasë parasysh evolucionin e pandemisë
12 apo është ende herët për të thënë një gjë të tillë.

13 Dhe së fundi, dua që Zyra Administrative të eksplorojë
14 mundësinë me mjekun e paraburgimit që mund të zbatohen
15 rregulla të tjera në qoftë se të dy palët janë të vaksinuar
16 plotësisht.

17 Ja jap fjalën, pra, Zyrës Administrative.

18 Z. ROCHE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

19 Do t'i trajtoj çështjen një nga një, siç thatë ju, për sa
20 i përket aksesit në dokumente. Siç e keni thënë ju, sistemi
21 elektronik po funksionon dhe ky është një sistem që i lejon
22 mbrojtësve dhe të akuzuarve të aksesojnë dokumentet në sistem,
23 në kompjuterin që e kanë në qelitë e tyre.

24 Për sa i përket qasjes në dokumente gjatë konsultimeve
25 midis palëve në objektin e paraburgimit, kemi rënë dakord mbi

1 bazën e parashtrimeve që bëri z. Rees, i kemi dhënë atij një
2 kompjuter portabël, ku mund të vendosen disa ekrane dhe ai
3 mund të shikojë bashkë me klientin të njëjtin ekran në të
4 njëjtën kohë.

5 Për sa i përket ndërveprimeve midis avokatëve mbrojtës
6 dhe klientëve kjo -- ne, në këtë drejtim, udhëzohemi vetëm nga
7 nevoja për të mbrojtur shëndetin e të gjithë njerëzve nga
8 pandemia. Ky vendim është bazuar në vendimin që është marrë
9 nga mjeku i shërbimeve të burgimit në Holandë dhe ne ndjekim
10 edhe praktikën e Tribunalëve të tjerë, të cilët kanë përvojë
11 në këtë fushë.

12 Kjo politikë po rishqyrtohet vazhdimisht. Është një
13 proces dinamik. Kufizimet shikohen, rishikohen vazhdimisht dhe
14 është dëshira dhe synimi jonë përfundimtar, si Zyrë
15 Administrative, që të hiqen këto kufizime kur të lejohet kjo
16 nga kushtet.

17 Për sa i përket vaksinimeve, vaksinimi i dytë i të
18 paraburgosurve është parashikuar për datën 4 qershor, por
19 është një -- ky është një faktor i rëndësishëm por jo
20 vendimtar, sepse janë edhe persona të tjerë aty, që janë rojet
21 e burgut dhe persona të tjerë që mund të kenë -- vaksinimi i
22 tyre mund të ketë ndikim në politikat që do të ndiqen.

23 Pra, mund të them këtë si përfundim, që kjo është një
24 çështje që ne e vlerësojmë dhe e dimë sa e rëndësishme është
25 dhe ne jemi të angazhuar vazhdimisht me mjekun e objektit të

1 paraburgimit në vijimësi.

2 Në qoftë se mund të vazhdojë, atëherë, të flas edhe për
3 dosjet elektronike në sistemin *Legal Workflow* dhe kalimin e
4 tyre nga *Legal Workflow* në sistemin elektronik për shkëmbimin
5 e dokumenteve?

6 Për sa i përket dosjeve për kalim -- për kalimin e
7 dosjeve elektronike me dokumente nga *Legal Workflow* në SED,
8 kjo është një çështje që po vazhdon. Ka disa çështje teknike
9 dhe faktikisht, unë nuk i kam ato njohuri teknike për të thënë
10 se çfarë duhet, por ne po e shqyrtojmë me prioritet në
11 krahasim me prioritetet e tjera për mirëmbajtjen e sistemit.

12 Për sa i përket memorieve të bartshme, USB, kjo nuk është
13 e mundshme, që të sillen këto USB në objektin e paraburgimit,
14 por kemi gjetur një mjet ndërmjetës që, siç e thashë, është
15 një kompjuter laptop, i cili ka mundësinë të paraqesë në ekran
16 të njëjtat pamje si për të paraburgosurin ashtu edhe për
17 avokatin. Sistemi elektronik për shkëmbimin e të dhënëve është
18 sistemi më i sigurt për shkëmbimin e dokumenteve.

19 Për sa i përket përkthimeve, ne i jemi përmbajtur
20 indikacioneve të mëparshme se kur do të jenë ato gati. Mbeten
21 akoma përkthime për t'u bërë, të cilat do t'i jepen Mbrojtjes,
22 jo më vonë se data 15 qershor, siç kemi thënë. Siç thotë
23 rregulli -- edhe përmbledhje e detajuar sipas rregullit
24 86(3) (b) është shpërndarë dhe u përfundua me datë 15 maj dhe i
25 është dhënë palëve me 18 maj, siç e kishim premtuar.

1 Besoj se këto janë çështjet që mu kërkuan mua t'i
2 trajtoj, po desha ta përmyll duke thënë se, ne e kuptojmë
3 rëndësinë që kanë heqja e kufizimeve të cilat janë vendosur
4 tani për shkak të pandemisë por, siç e thashë, kjo është diçka
5 që e shikojmë me seriozitet shumë të madh dhe angazhohemi në
6 të, ditë pas dite, duke diskutuar me mjekun e paraburgimit.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Roche.

8 Tani i kaloj fjalën Mbrojtjes.

9 Z. Rees.

10 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit ndihmës së Zyrës
11 Administrative, Zyrës së Mbrojtjes dhe ekipit të IT-së, të
12 Teknologjisë së Informacionit. Ne jemi angazhuar me ta
13 vazhdimisht kohët e fundit dhe me z. Gucati si ekip që të
14 gjejmë mundësi për të punuar.

15 Kjo zgjidhje për dhënien e një laptopi të veçantë është e
16 mirëpritur. Kjo na ndihmon shumë dhe efektiviteti i kësaj
17 zgjidhje do të përforcohet kur aftësia për të kopjuar dosje
18 materialesh dhe jo thjeshtë dokumente nga *Legal Workflow*, nga
19 sistemi *Legal Workflow* në memorien e kompjuterit, sepse ky
20 laptopi do të jetë mjeti me të cilin mund t'i çojmë dokumentet
21 në objektin e paraburgimit.

22 Ngritja e këtyre ekraneve në zonën ku fliten -- ku do të
23 flitet apo do të konsultohemi me klientët është një zgjidhje
24 tjetër dhe z. Stephenson do të shkojë për të ndihmuar në
25 instalimin e këtyre ekraneve, në mënyrë që të punohet në

1 mënyrë sa më të mirë.

2 E vetmja gjë që desha të shtoj është në lidhje me
3 lehtësimin e masave që janë vendosur në njësinë e paraburgimit
4 për arsye shëndetësore dhe vizitat nga familjarët.

5 Ne i jemi mirënjohës për indikacionin që më 4 qershor të
6 mbarojë procesi i vaksinimit. Ne, kemi kuptuar nga zyra që
7 drejton objektin e paraburgimit, që të gjithë edhe stafi edhe
8 të paraburgosurit janë vaksinuar plotësisht dhe ata që kanë
9 mbetur do të vaksinohen deri më 4 qershor.

10 Por duke -- pavarësisht, se ne e kuptojmë që mund të
11 ndodhin gjëra të paparashikuara, ne mendojmë që duhet caktuar
12 një datë në të cilën njësia e paraburgimit mendon t'i heqë
13 kufizimet në lidhje me kontaktin fizik të mbrojtësve me të
14 paraburgosurit dhe të lejojnë vizitat familjare.

15 Dhe besoj, që është e arsyeshme që të gjithë palët të
16 jenë të vaksinuar kur të hiqen këto masa. Pra, caktimi i një
17 date në të cilën të synohet heqja e këtyre masave për të bërë
18 takimet midis mbrojtësve dhe të paraburgosurve dhe për të
19 lejuar vizitat familjare me kalimin e kohës.

20 Kjo do të ishte kërkesa jonë.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

22 Tani z. Cadman.

23 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Edhe unë i
24 shpreh mirënjohjen time Zyrës Administrative, z. Roche, që i
25 trajtojë disa nga çështjet që kemi ngritur ne. Na vjen keq që

1 u desh një kohë kaq e gjatë për t'u marrë këto çështje
2 seriozisht, për t'u trajtuar seriozisht.

3 Unë jam dakord me komentet e z. Rees, që duhet të na
4 lejohet vizita me z. Haradinaj dhe unë, me sa di, z. Haradinaj
5 i ka bërë të dyja vaksinat edhe të paraburgosurit e tjerë po
6 ashtu. Por problemi qëndron tek rojet e burgut dhe siç jemi
7 informuar më parë, ndoshta kjo nuk do të përfundojë deri në
8 korrik dhe ndoshta kufizimet nuk do të hiqen deri në korrik
9 dhe kjo është e papranueshme.

10 Ne na është thënë nga Zyra Administrative, përpara, në
11 lidhje me këshillat mjekësore që janë dhënë nga mjeku i
12 paraburgimit. Ne kemi kërkuar këshilla mjekësore edhe për të
13 vendosur se çfarë është e mundur dhe çfarë ndryshimesh mund të
14 bëhen. Na është thënë se këshillat që ka dhënë mjeku nuk janë
15 me shkrim. Pra, është thjeshtë një pjesë e një mbledhje gojore
16 me -- dhe të zakonshme me administratoren.

17 Pra, themi edhe një herë, që këto kufizime të plota që
18 vazhdojnë të ekzistojnë dhe që mendohet e vazhdojnë deri në
19 korrik janë -- krijojnë një problem shumë serioz dhe se besoj
20 që këto kufizime të hiqen në qershor, siç u përmend.

21 Çështja me *Legal Workflow*, që po punon në mënyrë të
22 kënaqshme, është një sistem shumë i vështirë për t'u përdorur.
23 Ne e kuptojmë që transferimi i dosjeve elektronike drejt për
24 së drejti nga *Legal Workflow* në sistemin elektronik të
25 mbrojtur është një gjë që e mirëpresim por, siç dëgjuam nga z.

1 Roche, kjo nuk është plotësuar dhe nuk përfunduar ende.

2 Duhet të vendoset një sistem që të gjitha këto çështje të
3 trajtohen me prioritet. Sistemi i mbrojtur i shkëmbimit të
4 dokumenteve e ka përmirësuar situatën dhe ne i jemi mirënjohës
5 Zyrës së Administrative që e ka shtuar kapacitetin deri në 100
6 gigabajt për secilin të paraburgosur.

7 Por, sistemi i shkëmbimit të dokumenteve dhe ndryshimet
8 që janë bërë në *Legal Workflow* nuk janë zëvendësim për atë që,
9 ne, mund të ulemi me klientët tanë dhe t'i shikojmë materialet
10 një e nga një. Dhe sot, për herë të parë, po e dëgjoj për
11 çështjen e përdorimit të laptopëve të veçantë dhe të ekraneve
12 që do të përdoren. Kjo do t'i përmirësojë gjërat. Por, unë do
13 ta vizitoj z. Haradinaj të hënën dhe do të shoh vetë nëse kjo
14 është zgjidhje e përshtatshme apo jo.

15 Për sa i përket çështjes së përdorimit të USB-ve, është
16 krejtësisht logjike që të merret një CD-ROM në njësinë e
17 paraburgimit -- është krejtësisht e palogjikshme që në
18 objektin e paraburgimit të mund të futet dot CD-ROM dhe të mos
19 futet dot një memorie e bartshme USB. Unë s'e kuptoj
20 arsyetimin pas kësaj. Ju i nderuar Gjykatës, keni dhënë një
21 vendim kohët e fundit në lidhje me pamjet filmike, me këtë do
22 të -- këtë do ta trajtojmë më vonë. Por këto janë çështje që
23 në një gjykim të zakonshëm apo në procedura të zakonshme, ne
24 mund të uleshim me klientët tanë, të shikonim të gjithë
25 dokumentet, të gjitha materialet bashkë dhe të merrnim

1 udhëzimet e duhura prej tyre.

2 Po, siç e thashë, janë bërë përmirësime por me thënë të
3 drejtën, i nderuar Gjykatës, në këtë fazë ku jemi nuk është --
4 nuk mendoj se janë marrë masat e duhura për t'u përgatitur siç
5 duhet për gjykim.

6 Dhe çështja e përkthimit së fundi. Sigurisht, ne na vjen
7 mirë që është përsheptuar puna për përkthimin e dosjes
8 paraprake por nuk është ky i vetmi dokument që kërkohet. Ne
9 jemi një institucion i Republikës së Kosovës dhe nuk jemi
10 institucion ndërkombëtar dhe gjuha e këtij institucioni është
11 shqipja. Ata nuk flasin anglisht. Ata kanë të drejtë që të
12 marrin këto dokumente në gjuhën e tyre, pra, që dokumentet të
13 përkthehen.

14 Dhe ekziston detyrimi ligjor që të përkthehen disa
15 materiale. Ky do të ishte edhe rasti në qoftë se një qytetar i
16 huaj do të gjykohej në një vend tjetër që nuk është vendi i
17 tij. Këtu, këtë situatë kemi dhe këtu. Ky është një qytet --
18 ky nuk është rasti këtu. Ky është një qytetar i Kosovës, i
19 Republikës së Kosovës që po gjykohet para një institucioni të
20 Kosovës.

21 GJYKATËSI GUILLLOU: [Përkthim] Do t'ia jap fjalën z. Roche
22 që t'u përgjigjet ekipeve të mbrojtjes. Dhe dua që të sqaroni
23 gjithashtu, nëse data 4 qershor për vaksinimet ka lidhje vetëm
24 me të akuzuarit apo me personelin e njësisë së paraburgimit?
25 Dhe gjithashtu, për sa i përket avokatëve mbrojtës që nuk janë

1 në Holandë, nuk jetojnë në Holandë, po them këtë që rregulli
2 në Holandë është që vaksinimi bëhet vetëm mbi bazën e moshës
3 dhe prandaj ende ka shumë njerëz të cilët nuk janë vaksinuar,
4 megjithëse punojnë në vende të caktuara.

5 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar.

6 Sa i takon funksionimit të sistemit SEDS, Mbrojtja është
7 gjatë gjithë kohës e inkurajuar që të angazhohet me Zyrën e
8 Mbrojtjes d.m.th., me kolegët, me klientët e tyre ndërkohë që
9 ne do të trajtojmë çdo problem teknik që mund të ketë lidhja
10 me lidhjen në distancë. Pra, ne kemi bërë deri tani dhe do të
11 vazhdojmë edhe më tej të bëjmë çfarëdo gjëje që është e
12 mundur, në mënyrë që të mund të trajtojmë shqetësimet e
13 ndryshme që do të ngrihen nga Mbrojtja.

14 Sa i takon datës për vaksinimin, fatkeqësisht, nuk e kam
15 datën e saktë për përfundimin e procesit të vaksinimit për
16 zyrtarët e njësisë së paraburgimit. D.m.th., është ndoshta pak
17 më përpara sesa 4 korriku, por nuk është se e di me saktësi
18 datën. Një pjesë e të ndaluarve, e të paraburgosurve e kanë
19 bërë vaksinën. Por, siç e thashë edhe më përpara vaksinimi i
20 dytë për të gjithë të ndaluarit, të paraburgosurit do të
21 përfundojë deri më 4 korrik dhe ndërkohë do të vaksinohen edhe
22 pjesa e stafit të njësisë së paraburgimit.

23 Megjithatë, thashë edhe më përpara që është e rëndësishme
24 që të shikojmë edhe personat e tjerë të cilët hyjnë e dalin në
25 qendrën e paraburgimit dhe të sigurohemi edhe për sigurinë e

1 tyre shëndetësore po ashtu.

2 GJYKATËSI GUILLLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Roche.

3 Mbajta shënim kërkesën e zotit -- e Mbrojtjes së z.

4 Gucati, sa i takon përcaktimit të një date për kufizimet
5 d.m.th., kur do të hiqet data e kufizimeve. Ndërkohë, unë nuk
6 jam në gjendje që të jap një përgjigje për këtë pyetje të
7 Mbrojtjes së z. Gucati, por do ta rekomandoja fort Zyrën e
8 Administrimit që të konsultohet me stafin mjekësor dhe që të
9 nxirrte një datë të synuar apo një udhëzim që shpjegon se në
10 cilat kushte do të hiqen masat sepse, siç e tha dhe z. Roche,
11 ky është një proces dinamik, pra, nuk ka diskutim fare që ky
12 nuk është një proces i cili do qëndrojë kështu i pandryshuar
13 gjatë gjithë kohës. Është një proces i cili lidhet ngushtë me
14 KOVIDIN, me situatën e KOVIDIT. Pra, duhet të jemi në gjendje
15 që të marrim fjalën e autoriteteve përkatëse sa i takon heqjes
16 së kufizimeve.

17 Z. Cadman, shikoj që doni të merrni fjalën ju.

18 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Po, i nderuar.

19 Siç e kam përmendur dhe më parë, neve nuk e kemi parë
20 këshillimin e autoriteteve mjekësore edhe, me ç'kuptoju unë, as
21 ju i nderuar Gjykatës, nuk e keni parë atë çfarë kanë thënë
22 autoritetet mjekësore.

23 Mendoj, që është e nevojshme që juve të shihni
24 këshillimin mjekësor në mënyrë që të bëni përcaktim
25 proporcional e të nevojshëm lidhur me procedurat në fjalë.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

2 Z. Rees, keni ndonjë gjë për të shtuar?

3 Z. REES: [Përkthim] Jo, thjeshtë dua të mbështes
4 konstatimin e z. Cadman.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

6 Z. Roche keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar?

7 Z. ROCHE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar.

8 Diçka të fundit lidhur me këtë çështje, qasja e Zyrës së
9 Administrimit është që të bëjmë avokaci ose mbështetje për
10 heqjen e kufizimeve. Pra, thjeshtë do doja ta theksoja edhe
11 një herë këtë gjë, që ne duam që kufizimet të hiqen në
12 momentin e parë që mund të hiqen në mënyrë të përgjegjshme dhe
13 do të vazhdojmë të kemi të njëjtin qëndrim edhe në të ardhmen.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pra, mendoj që të gjithë ne
15 kemi të njëjtin objektiv. Por, kjo tani kërkon që ne të
16 punojmë bashkërisht edhe me nëpunësit e njësisë mjekësore në
17 mënyrë që kufizimet të hiqen sa më shpejtë të jetë e mundur.
18 Në çdo rast, ne do të monitorojmë procesin dhe fushatën e
19 vaksinimit në mënyrë që kufizimet të hiqen sa më shpejtë të
20 jetë e mundur.

21 Atëherë, nuk shoh se ka ndonjë person tjetër që do të
22 marrë fjalën lidhur me këtë çështje, nëse është ky rasti, do
23 të kalojmë me pikën e parë në rendin e ditës për sot.

24 Tani, dua që të dëgjoj nga palët lidhur me nxjerrjen e
25 materialit provues. Do të fillojmë me çështjen e kërkesës së

1 fundit të ZPS-së për mosnxjerrjen, e cila do të diskutohet në
2 seancë private, në seancë me dyer të mbyllura. Pastaj do
3 mblidhemi sërish në seancë publike për të diskutuar për
4 çështjet e tjera që kanë të bëjnë me nxjerrjen e informacionit
5 dhe me pjesën tjetër të rendit të ditës për sot.

6 Zoti sekretar, ju lutem, kalojmë seancën në seancë me
7 dyer të mbyllura.

8 [Seancë private]

9 [Seancë private teksti i fshirë]

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13 [Seancë e hapur]

14 SEKRETARI I GJYKATËS: Jemi në seancë publike

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti

16 Sekretar.

17 Tani le të kalojmë pak tek pjesa e procesit të nxjerrjes.

18 Së pari, vërej që ZPS-ja nuk parashikon vështirësi të tjera

19 lidhur me pjesën e mbetur të procesit të nxjerrjes.

20 Megjithatë, ZPS-ja ka treguar që më 7 maj 2021 ka marrë një

21 përgjigje të pjesshme për një kërkesë të një pale të tretë dhe

22 se materiali përkatës është nxjerrë më 25 maj të vitit 2021.

23 Kërkesa e palës së tretë mbetet ende pezull dhe

24 materialet pasuese të marra do të nxirren me përputhje me

25 kuadrin ligjor të zbatueshëm.

1 Në parashtrimet e tyre, mbrojta theksoi shqetësimet e saj
2 të shprehura edhe më parë për sa i takon vështirësive me
3 vazhdimësinë e nxjerrjeve. Do të doja t'ju kërkoja palëve që
4 të shpreheshin në qoftë se parashikojnë ndonjë vështirësi për
5 pjesën e mbetur të procesit të nxjerrjes dhe mbrojtja për z.
6 Gucati ka mundësi që të japë kundërshtime për sa i takon
7 pranueshmërisë deri në 14 qershor, ndërkohë që mbrojtja për z.
8 Haradinaj parashtron që nuk është e mundur kështu që do të
9 doja t'i jepja fjalën mbrojtjes për të bërë komentet e tyre.
10 Kështu që së pari Prokuroria fjala për ju.

11 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.
12 Së pari mirëpresim angazhimin e mbrojtjes së z. Gucati për të
13 dhënë kundërshtimet e tyre për pranueshmërinë e provave deri
14 në 14 qershor. Megjithatë ne vërejmë që mbrojtja tha që detaje
15 që mbështesin kundërshtime të tilla nuk do të jepen më pas.
16 Nuk thuhet se çfarë do të ndodhë më pas por ndërkohe që vetëm
17 thjeshtë pohimi i kundërshtimit të mospranueshmërisë është një
18 zë i kufizuar dhe nuk është se ka ndonjë përdorim shumë të
19 madh në qoftë se nuk mund të jepen detaje të tjera të
20 hollësishme lidhur me të kështu që në këtë kuadër do të doja
21 që t'ju kërkoja avokatit mbrojtës që të japin edhe arsyen për
22 këtë dhe jo vetëm thjeshtë të konstatojnë faktin që do të
23 kundërshtojnë pranueshmërinë.

24 Sa i takon parashtrimet nga ana e mbrojtjes së z.
25 Haradinajt, e di që mbrojtja bën pretendime të përgjithshme,

1 akuza të përgjithshme që këto nuk janë materiale të cilat po
2 nxirren në kohë që ZPS-ja është përgjigjur disa herë,
3 përfshirë këtu edhe në një parashtrim me shkrim dhe domethënë
4 nuk është se dua të futem në shumë detaje, sa i takon, le të
5 themi, respektimit të afatit kohor të përcaktuar nga Gjykata
6 por historiku i çështjes në vetvete tregon që çfarë kemi bërë
7 ne.

8 Lista e provave është depozituar në 9 prill, në përputhje
9 me kalendarin e konsoliduar dhe është bërë një shtesë e
10 autorizuar e vetme për shkak të arsyeshëm dhe pra pjesa e
11 listës së provave, ka qenë pjesë e materialeve mbështetëse që
12 i janë vënë në dispozicion mbrojtjes që në fillim të janarit.

13 E kemi thënë edhe më parë që ka pasur çështje dhe kohë të
14 mjaftueshme për të vlerësuar elementin apo akseptin e
15 pranueshmërisë.

16 Sa i takon nxjerrjes në datë 25 maj vërejmë që mbrojtja
17 ka theksuar shumë faqe që ka të bëjë me nxjerrjen e
18 materialeve që janë marrë kohët e fundit nga palët e treta. Së
19 pari kjo nxjerrje nuk ka ardhur e papritur ndryshe nga çfarë
20 parashtruar nga mbrojtja. Se ZPS-ja ka thënë njoftim paraprak
21 të paktën në tre konferenca për gjendje gjyqësore që ka edhe
22 një kërkesë pezull drejtuar një pale të tretë dhe se material
23 përkatës do të nxirrej sa më shpejtë që të merrej prej kësaj
24 pale të tretë.

25 Dua të theksoj po ashtu që natyra e këtij materiali nuk

1 është një përmbledhje deklaratash apo nuk është një narrativë
2 që duhet që të vlerësohet rresht për rresht. Por bëhet fjalë
3 për një bazë të madhe të dhënash dhe kemi të bëjmë me shumë
4 informacione të cilat do të duhet që të trajtohen bashkërisht.
5 Kështu që ndikimi që mbrojtja pretendon që kjo nxjerrje të
6 ketë mbi përgatitjen e tyre nuk mund të matet në raport me
7 numrin e faqeve. Faleminderit.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.
9 Prokurore.

10 Tani Z. Rees. Z. Rees!

11 Z. REES: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, pozicioni i ZPS-
12 së po bëhet gjithmonë e më i pavërtetë, domethënë këtu po na
13 thuhet gënjeshtër. Do ju kaloj tani historinë.

14 Në seancën e parë, domethënë për konferencën e parë për
15 ecurinë e çështjes u caktua një afat 19 shkurt 2021 për
16 nxjerrjen e materiale sipas rregullave 102(1), 102(3) dhe 103.
17 Dhe në atë konferencë të parë për ecurinë e çështjes ata thonë
18 që nuk kishin shumë materiale për të nxjerrë në bazë të
19 rregullës 102.

20 Në konferencën e dytë në 24 shkurt, ju thanë, i nderuar
21 Gjykatës që në 19 shkurt Prokuroria i kishte përmbushur të
22 gjitha detyrimet e saj sipas rregull[ës 102(1)(b)]. Në atë
23 fazë, ishin nxjerrë rreth 3000 faqe material. Mbrojtja kërkoi
24 në atë fazë -- sepse megjithëse se ishin vetëm 300 faqe, aty
25 ishin materiale të transkriptuara me shumë orë materiale në

1 video dhe ne parashikuam si mbrojtje që do të kishim detyrimin
2 të bënim hetimet tona në lidhje me to dhe kërkua që në 2
3 korrik 2021 të caktohej afati për dorëzimin e dosjes
4 paraprake, të cilin ne ende mendojmë që do ta dorëzojmë.

5 Pas kësaj konference të dytë për ecurinë e çështjes, ju i
6 nderuar Gjykatës, nxorët një kalendar përmbledhës i cili solli
7 përpara afatin për dorëzimin e dosjes paraprake të mbrojtjes
8 deri në datën 14 qershor, pra 2 javë më çarë se sa ishte
9 parashikuar. Kjo ishte mbi bazën e asaj që Prokuroria ju tha
10 ju i nderuar Gjykatës, në mënyrë të qartë se i gjithë
11 materiali i rregullës 102(1) ishte dorëzuar.

12 Në konferencën e tretë për ecurinë e çështjes, Prokuroria
13 përmendi dy kërkesa që ende nuk kishin marrë përgjigje që ato
14 i kishin bërë palëve të treta. Nuk na u tha se cilat ishin
15 këto palë të treta, çfarë lloj materiali ishte edhe sa
16 material do të pritej të merrej prej tyre. As nuk na thanë, as
17 nuk ju thanë juve, i nderuar Gjykatës, që për shembull nuk
18 dimë se sa volum material do të sjellin këto kërkesa.

19 Ata ju thanë, i nderuar Gjykatës, në paragrafin 8 të
20 parashtrimeve të tyre me shkrim se pjesa më e madhe e
21 materialeve të dorëzuara nga ZPS-ja ishte përfunduar në 19
22 shkurt dhe ata e përsëritën të njëjtën gjë sot sepse thanë
23 pjesa më e madhe dhe nuk e kuptoj se çfarë kuptimi i japin ata
24 kësaj fjale, - pjesa më e madhe, sepse nuk e besoj që është në
25 kuptimin matematik. Por përshtypja që krijohet, për ju i

1 nderuar Gjykatës dhe për palët është që çfarëdo që kishte
2 mbetur pa u dorëzuar nga këto materiale nuk do të kishte
3 ndonjë -- nuk do ishte shumë voluminoze dhe ata përforcuan
4 këtë përshtypje duke thënë që çdo material tjetër që mund të
5 vinte do të dorëzohej deri në 9 prill 2021.

6 Në 9 prill 2021 erdhi dhe shkoi dhe do t'ju kujtohet
7 besoj i nderuar Gjykatës që në konferencën e kaluar, të
8 katërtën pra, për ecurinë e çështjes ose një natë para asaj
9 konference, u bënë disa nxjerrje të tjera materialesh. Dhe
10 këto kishin të bënin me rregullën 102(3).

11 Pavarësisht nga fakti se ju i nderuar Gjykatës e kishit
12 urdhëruar që dorëzimet të bëheshin deri në 19 shkurt, unë nuk
13 do ta lë të gjithë historinë e njoftimit në bazë të rregullës
14 102(3), që është për të ardhur keq, edhe ajo histori sepse ju
15 e dini i nderuar Gjykatës dhe përgjigja që dhanë ata ishte që
16 "po, ne e bëmë këtë nxjerrje". Ato u bënë një natë përpara
17 konferencës, por ishim të dhënë -- duke i dhënë përgjigje
18 urdhrit tuaj, i nderuar Gjykatës. Pra nuk mund të ndihmonin me
19 këto materiale sepse na i sollën këto materiale dhe nuk kishim
20 si t'ja bënim. Duhej t'i dorëzonim. Dhe siç e thashë, data e
21 parë e caktuar ishte 19 shkurti. Kur shkoi -- të gjithë
22 materialet e rregullës 102(3) sipas Prokurorisë ishin dorëzuar
23 deri atëherë. Ishin 17 dosje plot me materiale.

24 Në konferencën e 4 për ecurinë e çështjes kur ne ende nuk
25 kishim mundur të bënim vlerësimin e materialit që na kishin

1 dhënë faktikisht një natë para konferencës, besoj se ju
2 kujtohet i nderuar Gjykatës, që unë dhe z. Cadman ju kërkuam
3 të shqyrtohej kjo çështje: "si mund të dorëzoheshin dokumentet
4 një ditë apo një natë përpara konferencës?". Prokuroria e
5 siguroi Gjykatën se materiali sipas rregullës 102(1) kishte
6 përfunduar.

7 Ata thanë se kishte mbetur vetëm një kërkesë në listën e
8 provave materiale dhe kjo lidhej me deklaratën e dëshmitarit
9 04841. Kjo deklaratë ishte e 14 prillit 2021, e cila na ishte
10 dorëzuar në atë kohë. Ne kishim një kopje të kësaj deklarate
11 dhe Prokuroria tha specifikisht që kishte një kërkesë të vetme
12 që i kishte mbetur pa i marrë përgjigje në lidhje me atë
13 deklaratë.

14 Pra, pavarësisht nga konfirmimi prej tyre, para jush i
15 nderuar Gjykatës, në konferencën e 4-t për ecurinë e çështjes,
16 se do të kishte vetëm një kërkesë të vetme ende që priste
17 përgjigje dhe pavarësisht që ne kishim kërkuar me arsye që
18 Prokuroria të mos na japi këto dokumente një natë përpara
19 konferencës për ecurinë e çështjes dhe pavarësisht nga fakti
20 që ata e dinin që ne nuk kishim kohë t'i shihnim se çfarë
21 kishte aty, ata e dinin se aty kishte një material mjaft
22 voluminoz, 17 dosje të trasha të mbushura plote me materiale,
23 dhe pavarësisht nga ajo që bënë, në konferencën e 4-t, ata
24 tashti para konferencës së 5-të për ecurinë e çështjes, bënë
25 të njëjtën gjë.

1 Dhe megjithëse e kishin pasur këtë material që më herët
2 në maj, ata na dorëzuan 18549 faqe, në bazë të rregullës
3 102(1) dhe pavarësisht se ju siguruan që kjo kishte të bënte
4 vetëm me një atë kërkesë, vetëm me kërkesën e vetme që kishte
5 mbretur pa marrë përgjigje në lidhje me deklaratën e
6 dëshmitarit 04841, ata i çuan këto 18 mijë e ca faqe dhe bënë
7 kërkesën që ta shtojnë këtë në listën e provave materiale. Dhe
8 gjithashtu shtuan se do të kishte edhe materiale të tjera.
9 Megjithëse kjo është një pjesë e mënyrës se si sillen ata dhe
10 ata nuk na ndihmojnë as ne dhe nuk ju ndihmojnë dhe as ju i
11 nderuar Gjykatës. Nuk thonë as se çfarë materiali është, sa
12 shumë material është dhe çfarë është.

13 Ata u përpoqën t'ju sigurojnë edhe një herë, i nderuar
14 Gjykatës, që këto 18549 faqe që duan t'i fusin në listën e
15 provave materiale, nuk kanë një ngarkesë shumë të madhe. Më
16 falni por unë si avokat, si çdo avokat i mirë duhet të bëjë,
17 do të jap mendimin tim për atë material vetëm pasi e kam parë,
18 e kam shqyrtuar dhe kam folur me klientin tim për të. Dhe unë
19 nuk mund ta bëj këtë në lidhje me këto 18549 faqe, me material
20 dhe prova shumë komplekse, shumë teknike, në mënyre shpejtë e
21 shpejtë. Nuk mund të bëj kapërcime dhe unë nuk mund t'ju jap
22 asnjë lloj sigurie, i nderuar z. Gjykatës nëse ky material ka
23 rëndësi apo jo.

24 Juve ju kanë siguruar disa herë Prokuroria ose janë
25 munduar t'ju sigurojnë, megjithëse janë të rinj dhe shpesh

1 kanë bërë premtime të cilat nuk -- të cilave nuk i janë
2 përmbajtur dhe këtë shqetësim e kam shprehur edhe në
3 konferencën e kaluar për ecurinë e çështjes edhe në atë më
4 përpara dhe ky skepticizmi im nuk duket se po ngushëllohet,
5 por vetëm po rritet më tej.

6 Ne sigurisht duhet të merremi edhe me 17 dosje plotë me
7 material të cilat na u dorëzuan para konferencës së 4-t dhe
8 plus atyre kemi edhe 18549 faqe shtesë që na u dhanë në prag
9 të kësaj konference për t'i lexuar, për t'i analizuar, të
10 pyesim klientët tanë në lidhje me to dhe me sa duket siç po na
11 thonë, presim edhe materiale të tjera pa na thënë se çfarë
12 materiali do na vijë dhe se çfarë volumi do të ketë. Nuk po na
13 thonë as nëse Prokuroria e di se sa material do të ketë që do
14 të na japin dhe që do të shtojnë në listën e provave
15 materiale.

16 Ka ardhur koha që Prokuroria ta kuptojë që duhet të
17 shprehet sinqerisht dhe ndershmërisht para Gjykatës. Ne e dimë
18 që ka materiale të tjera që do t'i nxjerrin ata sepse e dimë
19 që ju i nderuar Gjykatës keni urdhër për të.

20 Një aspekt i urdhrit tuaj i cili hidhte poshtë kërkesën e
21 Prokurorisë në lidhje me mosnxjerrjen e materialeve që kanë të
22 bëjnë me videot e kontrolleve që janë bërë, ju e keni bërë
23 këtë vendim edhe me shkrim dhe me gojë dhe megjithëse kishte
24 11 video të cilët ishin përmendur në njoftimin, sipas
25 rregullës 102(3) ato ishin përsëritje të njëra-tjetrës. Ato

1 faktikisht ishin dy video që ishin kopjuar 10 herë. Ashtu
2 thanë ata.

3 Por kjo nuk ishte e vërtetë sepse pasi i nderuar Gjykatës
4 dhatë urdhër që të na jepej qasje në ato video, ne morëm masa
5 për t'i parë dhe na u tha që ishin edhe 8 video të tjera të
6 cilat ishin zbuluar. Sigurisht, ato na janë dhënë pas urdhrorit
7 që dhatë ju, i nderuar Gjykatës. Por përsëri kjo na shkakton
8 shqetësim të mëtejshëm në lidhje me atë nëse Prokuroria po i
9 kryen ashtu siç duhet detyrat e veta karshi jush ndër të tjera
10 edhe për listën e të gjitha materialeve që kanë në zotërimin e
11 tyre sipas rregullës 102(3). Këto 8 video nuk ishin pjesë e
12 asaj liste.

13 Pse nuk u zbulua para ditës së djeshme? Pse nuk ishin ato
14 të përfshira në njoftimin sipas rregullës 102(3)? A është bërë
15 ndonjë përpjekje e njëmendshme për ta identifikuar këtë
16 material që ka zyra e z. Smith që pastaj ky material të
17 përfshihet në një njoftim të hollësishëm që është i plotë,
18 gjithëpërfshirës, me të gjitha, me informacion të mjaftueshëm
19 për mbrojtjen për të bërë parashtrimet e duhura nëse ato
20 materiale që janë në atë listë, janë të rëndësishme për
21 përgatitjen e mbrojtjes apo jo.

22 Nga kjo rrjedh që do të ketë edhe materiale të tjera që
23 do të dorëzohen sipas njoftimi -- të rregullës 102(3) ose të
24 paktën do të ketë, në qoftë se Prokuroria është serioze në
25 lidhje me detyrimet e saj ose të paktën duhet që Prokuroria të

1 bëjë një version tjetër të listës apo njoftimit sipas
2 rregullës 102(3).

3 Pse kërkojmë version të ri? Kjo rrjedh nga vendimi që
4 keni marrë ju i nderuar Gjykatës, sepse ju keni dhënë urdhër
5 për të bërë nxjerrje materialesh në atë që u përshkrua si
6 kërkesa Gucati, kërkesa A e Gucatit. Kërkesa A e Gucatit
7 lidhet me materialet që mungonin nga dokumentet e dorëzuar
8 sipas rregullës 102(3) dhe Prokuroria u detyrua ta jepte këtë
9 material mbasi u bë diskutimi apo ne vumë në diskutim
10 përshtatshmërinë e asaj që ata e quajnë rregulla ose pika e 13
11 e rregullës 102(3) dhe ju nga 13 që kishin ndërmend të
12 dorëzonin ata, ju e zgjeruat këtë listë te mbi 100. Më duket
13 se ishte më afër 150.

14 Asnjë nga ky material që përfshihej në kërkesën A të
15 Gucatit dhe sipas urdhrit tuaj, i nderuar Gjykatës, që duhet
16 të dorëzoheshin, këto materiale, asnjë prej këtyre nuk ishte
17 përfshirë në listë dhe nëse një dokument bëhet i ditur dhe ky
18 dokument nuk ka nevojë që të bëhet me anë të një njoftimi,
19 sipas rregullës 102(3), kjo duhet të bëhet përmes një shtojce,
20 ndaj njoftimi të bërë sipas rregullës 102(3).

21 Në lidhje me materialet sipas rregullës 102(1)(b) që na
22 njoftojnë me anë të emailit duke na informuar se ky material
23 që na u dha kohët e fundit ishte 18549 faqe, unë mendoj që [e
24 pa kuptueshme] duhet të përcaktoni afate për çdo material të
25 cilin Prokuroria do ta dorëzojë në bazë të rregullës 102(1)

1 dhe mendojmë që ju i nderuar Gjykatës duhet të përcaktoni një
2 afat të shkurtër për të reflektuar kërkesën që bën Gjykata, se
3 ka ardhur koha që ato konfirmimet, apo premtimet e vazhdueshme
4 të Prokurorisë që materialet janë dorëzuar të gjitha, ka
5 ardhur koha që këto premtime të mbahen.

6 Ju e keni thënë edhe më përpara edhe në konferencën e
7 kaluar për ecurinë e çështjes, po kështu kemi thënë edhe ne si
8 mbrojtje, që kemi ndërmend që të dorëzojmë dosjen tonë
9 paraprake në 14 qershor, siç e keni përcaktuar ju, dhe thamë
10 që në të njëjtën kohë do të identifikonim edhe çfarë
11 kundërshtimesh kishim ndaj pranueshmërisë së provave.

12 Në parashtrimin tonë me shkrim ne shprehëm që nuk do të
13 jemi gati për 14 qershorin, pra që të dorëzojmë dosjen
14 paraprake në kohë. Nuk mund të jemi gati, nën dritën e asaj se
15 si i ka trajtuar çështjet apo se si i ka bërë përgatitjet
16 Prokuroria. Domethënë duke premtuar që materialet janë nxjerrë
17 dhe pastaj na nxjerr gjëra të papritura herë pas here. Sidomos
18 brenda muajit të kaluar kemi marrë 17 dosje dhe 18 mijë e ca
19 faqe materiale.

20 Pra kërkojmë nga Gjykata që ta ndryshojë këtë afat për
21 dorëzimin vullnetar të dosjes paraprake të mbrojtjes, pra të
22 ndryshohet data, të mos jetë më 14 qershor. Ne kemi përcaktuar
23 se për të ndihmuar sa më shumë procesin ne do të përpigemi të
24 bëjmë një sillte të dokumenteve në listën e provave materiale
25 siç është tani, kundër të cilave do të shprehem kundërshtimet

1 tona për mospranueshmëri të tyre, pra.

2 Dhe këto 13 dokumente që ishin në fillim në listën e tyre
3 sipas rregullës 102(3), edhe ato vetë ato 13 dokumente sikur
4 të shihen, janë mjaft të gjata, voluminoze dhe do të kërkojnë
5 kohë dhe në atë listë ne do të kemi një kolonë ku me një fjalë
6 ose dy mund të japim natyrën e përgjithshme të kundërshtimit
7 tonë. Për shembull, mund të themi aty fjalë të dëgjua nga të
8 tjerët. Por nuk do jemi në gjendje të bëjmë opsione apo
9 parashtrime të hollësishme në lidhje me kundërshtimin mbi
10 bazën e pranueshmërisë ose jo të materialeve që do të
11 shikojmë.

12 Pra kemi ende 17 dosje plotë me materiale dhe 18 mijë e
13 ca faqe që duhet t'i shikojmë. Janë materiale mjaft teknike,
14 të cilat na i kanë dhënë vetëm kohët e fundit. Pra në frymën e
15 dhënies së ndihmës tonë për një procedurë sa më të shpejtë, ne
16 do të japim sa më shpejtë që të jetë e mundur dhe brenda
17 mundësive tona, listën e provave materiale që kemi ndërmend
18 t'i kundërshtojmë, duke përshkruar edhe me një fjalë ose dy,
19 se cila është arsyeja për kundërshtimin e tyre, pra siç thashë
20 përpara, mund të jetë arsyeja është dëgjuar -- fjalë të
21 dëgjua nga të tjerët dhe jo dëshmi e drejtpërdrejtë dhe në
22 qoftë se ju pastaj e kuptoni këtë pozicionin tonë [e
23 pakuptueshme] Gjykatës, ju mund të caktoni një datë në lidhje
24 me këtë.

25 Për sa i përket dosjes paraprake të mbrojtjes, se kur do

1 të jetë gati ajo, unë e kam të vështirë ta them në këtë kohë
2 për shkak të gjendjes flux në të cilën gjendemi tani, prandaj
3 edhe nuk mund të përcaktojmë një afat. Jo vetëm kemi këto
4 çështje të cilat sapo i ngritëm, jo vetëm që kemi edhe
5 sugjerimin që do të na vijjnë edhe materiale të tjera sipas
6 rregullës 102(1)(b), pa ndonjë indikacion se çfarë përmbajnë
7 ato materiale, jo vetëm që kemi materiale të tjera të cilat do
8 të na bëhen të ditura sipas urdhrit tuaj, i nderuar Gjykatës,
9 edhe këto do të na vijjnë në të ardhmen jo vetëm që kemi
10 çështjen në lidhje me dokumentin 99 etj., etj., ku ju e
11 kuptoni i nderuar Gjykatës për çfarë e kam fjalën, dhe jo
12 vetëm kemi ato materiale që do të na vijjnë në bazë të vendimit
13 që do të merret, por ne e kemi edhe një apel ende të
14 pashqyrtuar në Gjykatën e Apelit, në lidhje me fushëveprimin e
15 aktakuzës dhe deri sa të marrim atë vendim nga Gjykata e
16 Apelit nuk mund të themi, por ju i nderuar Gjykatës, ju e
17 shikoni që ka pasoja se çfarë -- si do të përgatitet mbrojtja
18 në varësi të vendimit që do të marrim nga Gjykata e Apelit.

19 Por duke dashur të ndihmojmë dhe duke e nxitur Gjykatën
20 që të caktojë një datë paraprake, duke e kuptuar se ndoshta me
21 kalimin e kohës ky afat nuk mund të plotësohet, data e
22 tanishme 14 qershorit mund t'ju shërbejë, i nderuar Gjykatës,
23 si një afat i duhur që Prokuroria të trajtojë të gjitha
24 çështjet që i kanë mbetur të patrajtuara dhe deri aty -- dhe
25 nuk ka më shtyrje të afatit. Dhe në qoftë se edhe kjo

1 plotësohet, 28 ditë pas asaj, pas 14 qershorit, që është data
2 12 korrik, ne do të punojmë për çështjet të cilat do të mund
3 të punojmë brenda kësaj faze dhe në skenarin më të mirë, do të
4 mund ta dorëzojmë dosjen tonë paraprake në datë 12 korrik.

5 Besoj që kjo është për të gjitha palët, pra që të gjitha
6 palët propozojnë që të bëhet një konferencë tjetër për ecurinë
7 e çështjes përpara dorëzimit të dosjeve paraprake dhe
8 transmetimit të çështjes Trupit Gjykues. Dy javë, mbas kësaj,
9 pra mbas 12 korrikut, do të jetë e hënë 26 korrik dhe kjo
10 është para datës së pushimeve kur merr pushim Gjykata, pro
11 ndoshta 26 korriku do të ishte data e përshtatshme për të bërë
12 një konferencë të ardhshme për statusin e çështjes, për
13 ecurinë e çështjes në atë fazë. Por tani ne nuk mund të themi
14 se sa do t'i ketë zgjidhur çështjet ende të pazgjidhura
15 Prokuroria deri në atë fazë.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë z. Rees.
17 Atëherë shikoj që kemi dy orë që jemi mbledhur, domethënë
18 [keni] dy sekonda po ashtu,

19 Z. Rees: [Përkthim] Tthjeshtë doja të thosha që z.
20 Stephenson do të largohet dhe ndoshta mund të bëjmë një pushim
21 të shkurtër.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë i kërkoj ndjesë
23 përkthyesëve, sepse nuk mendova se do të flisnim kaq shumë, z.
24 Rees, kështu që ndjesë edhe një herë përkthyesëve dhe kështu
25 do bëjmë një pushim tani prej 20 minutash dhe do të kthehemi

1 sërish në sallën e Gjyqit në 20 minuta për të vijuar me pjesën
2 e mbetur të seancës.

3 Seanca mbyllet.

4 --- Pushimi filloi në orën 13:02

5 --- Seanca rifilloi në orën 13:20

6 Sekretari i Seancës: [Përkthim] Të gjithë në këmbë. Ju
7 lutem zini vend.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirë se u kthyet. Do të
9 vijojmë më tej me çështjen e nxjerrjeve. Z. Cadman, fjala për
10 ju, por përpara se t'ju jap fjalën, thjesht dua t'ju informoj,
11 z. Cadman se mbrojtja tjetër ka një fluturim për të kapur
12 kështu që do ju kërkoja që të mos ishit shumë shkurt,
13 domethënë pala tjetër e mbrojtjes kërkon që në qoftë se është
14 e mundur ta shkurtonit ndërhyrjen tuaj në mënyrë që të mund
15 t'ju ndjekim deri në fund dhe në mënyrë që të mund të kapin
16 fluturimin.

17 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes video lidhjes] I nderuar
18 Gjykatës, e kuptoj që kolegu im dhe ekipi i tij duhet të
19 largohet në mënyrë që të kapin flurimin, në fakt kolegu im e
20 trajtoi këtë çështje në detaje dhe në hollësi, kështu që unë
21 do të mundohem të flas sa më shkurt që të jetë e mundur.

22 Më lejoni të filloj duke thënë se është në interes të z.
23 Haradinaj që këto çështje të trajtohen me shpejtësi dhe pa
24 diskutim që nga ana jonë nuk ka absolutisht, nuk ka asnjë lloj
25 synimi që të vonojmë këto procese gjyqësore kështu që nuk

1 është në përfitimin tonë, pra të mbrojtjes, që të zgjasim
2 procesin gjyqësor përtej asaj çfarë është absolutisht e
3 nevojshme.

4 Thënë kjo, konstatimet që kemi bërë në parashtrimet me
5 shkrim lidhur me vizibilitetin e dosjes paraprake deri në 14
6 qershor, është sigurisht një çështje e cila lidhet në mënyrë
7 të drejtë për drejtë me 17 dosje të cilat na janë shërbyer, na
8 janë vënë në dispozicion përpara seancës së fundit për ecurinë
9 e çështjes, si dhe mbi 18 mijë faqe që të cilat na janë vënë
10 sërish në dispozicion nga Prokuroria. Kështu siç u tha edhe
11 nga kolegu im, ne do të duhet që të shqyrtojmë këto dokumente
12 në cilësi. Ne i kemi kërkuar z. Buckley që të merret me këtë
13 pikë posaçërisht. Megjithatë, më lejoni të them se dua të them
14 disa komente të cilat në fakt i kam bërë edhe gjatë
15 parashtrimeve të mëparshme.

16 Një prej shqetësimeve që kemi ne është se duket sikur ka
17 një model ose një temë që përsëritet, në shumë prej këtyre
18 çështjeve përpara Dhomave të Specializuara që na shqetëson.
19 Ndërkohë, arrestimet janë bërë, janë lëshuar edhe aktakuza,
20 ndërkohë që z. Haradinaj, pra klienti im, ka 8 muaj që mbahet
21 në paraburgim, ndërkohë që shihet që nuk -- ZPS-ja nuk është
22 në pozicionin e duhur për të vijuar më tej me procese
23 gjyqësore.

24 Jo vetëm ka, por shohim shkelje dhe mosrespektim flagrant
25 të përsëritur të transparencës, të procesit të drejtë

1 gjyqësor, të të drejtave të njeriut dhe këto janë shqetësime
2 të cilat janë të rëndësishme për ne. Dhe këto kërkesa të
3 arsyeshme që ne kemi bërë janë përgjigjur nga ZPS-ja në mënyrë
4 të vonuar dhe në mënyrë të tillë që procedurat të vijohen më
5 tej me efikasitet, ashtu siç e thashë më parë, ZPS-ja kërkon
6 që të na sjellë çështjen dhe të nxjerrë të themi materialet,
7 jo vetëm për ne, për mbrojtjen, por gjithashtu për ju i
8 nderuar Gjykatës.

9 Neve nuk kemi akses për të analizuar materialin e tyre,
10 ndërkohë që ZPS-ja planifikon që të mbështet tek deklaratat e
11 dëshmitarëve të cilat neve nuk është se do të jemi në gjendje
12 që t'i marrim në pyetje. Kështu që Prokuroria kërkon që të
13 gjithë çështjen të mund ta mbështesë në anonim, në seanca me
14 dyer të mbyllura, po gjithashtu edhe me dëshmitarë të cilët do
15 të dëshmojnë me figurë dhe me zë të tjetërsuar.

16 E kemi thënë shpesh herë në këtë Gjykatë që kemi bërë në
17 mënyre të vazhdueshme për ZPS-në lidhur me mënyrën se si
18 dokumentet thuhet që kanë rrjedhur. Ne jemi të shqetësuar
19 lidhur me këtë gjë, sigurisht ne kemi të drejtë që të hetojmë
20 se si ka ndodhur rrjedhja dhe duhet që të përgatisim mbrojtjen
21 lidhur me këtë.

22 Kërkesat që i kemi bërë Prokurorisë janë përgjigjur nga ZPS-ja
23 që këto janë çështje të cilat nuk janë në lidhje me procesin
24 gjyqësor. Ne kemi kërkuar disa herë në qoftë se janë marrë
25 masa kundër ZPS-së, anëtarëve të ZPS-së, të cilët mund të jenë

1 lidhur ose jo me rrjedhjet e materialeve. Por ne kemi të
2 drejtë që të dimë se çfarë hetimesh janë bërë dhe gjithashtu
3 kemi të drejtë që të bëjmë hetimet tona lidhur me lëndën.

4 Jemi të informuar që një numër i konsiderueshëm i stafit
5 të ZPS-së kontratat e të cilëve nuk janë zgjatur menjëherë pas
6 rrjedhjes, mund të jenë të lidhur ose jo me këtë çështje.
7 Megjithatë, të gjitha këto janë lëndë ose pika të cilat ne
8 duhet të kemi të drejtë që t'i hetojmë dhe të dimë se çfarë ka
9 bërë Prokuroria lidhur me to. Neve mendojmë që mungesa e
10 hetimit efektiv nga ZPS-ja është shumë e lidhur dhe shumë e
11 rëndësishme për këtë çështje. Tani, më lejoni të them kjo --
12 ne kemi gjithashtu edhe shqetësime sa i takon edhe zinxhirit
13 të ruajtjes, domethënë pra duam të dimë gjithashtu edhe
14 mënyrën se si e ka trajtuar ZPS-ja këtë gjë.

15 I nderuar Gjykatës, juve keni nxjerrë një vendim para
16 disa ditësh sa i takon aftësisë për të shikuar videot të cilat
17 janë regjistruar dhe që kanë të bëjnë me kontrollin dhe
18 sekuestrimin e materialeve. Neve na është thënë që kemi të
19 drejtë vetëm që ta shikojmë këtë material në ambientet e ZPS-
20 së me stafin e ZPS-së. Neve nuk na është lejuar, nuk na
21 lejohet që të bëjmë -- të mbajmë shënime, të kemi kopjet tona
22 të këtyre regjistrimeve në video, dhe ne nuk -- pra kjo është
23 situata në të cilën ne gjendemi dhe kjo në vetvete është një
24 akuzë e rëndësishme përpara Dhomave të Specializuara.

25 Pra, nuk është punë e mbrojtjes që të diskutojmë palë të

1 treta apo [e pakuptueshme] ndërkombëtare ndërkohe që ne na
2 thuhet që dokumente të caktuara nuk na jepen dot sepse janë
3 objekt i konfidencialitetit dhe sepse janë dhëna nga palët e
4 treta.

5 Dhe ne do të apelojmë vendimin në qoftë se e shikojmë të
6 rëndësishme lidhur me atë çfarë ne e konsiderojmë një gabim të
7 kërkesave të kërkesave të y. Gucati B dhe C. Këto janë çështje
8 të cilat janë shumë të rëndësishme për përgatitjen e
9 mbrojtjes. Dhe për këtë arsye duam që të kemi mundësinë që të
10 bëjmë hetimet tona.

11 Këto janë konstatime shumë sipërfaqësore dhe të
12 përgjithshme i nderuar Gjykatës, të gjitha ato çështje janë të
13 rëndësishme për ne dhe vijojnë të cënojnë punën tonë dhe e
14 bëjnë të pamundur që ne të vijojmë më tej me realizimin e
15 punës tonë në baze të afateve që janë përcaktuar prej jush, i
16 nderuar Gjykatës.

17 Do të jetë shumë e vështirë për ne që të respektojmë
18 afatin kohor dhe që të kemi mendësi që të bëjmë parashtrimet
19 tona brenda 16-17 ditësh përpara se sa të jemi në gjendje që
20 të japim dosjet paraprake. Sigurisht ne jemi -- synojmë që të
21 bëjmë më të mirën tonë dhe të trajtojmë çdo lloj marrëveshje
22 që të bëjmë pikat e ligjit ashtu siç kemi diskutuar edhe më
23 parë me ZPS-në. Nuk jemi në kundërshtim që ta bëjmë këtë gjë
24 në këtë fazë. Shpresojmë që të kemi mundësi që të mund ta
25 bëjmë këtë gjë dhe që ta dorëzojmë dosjen paraprake në kohën e

1 caktuar megjithatë unë dua që të them që është jo realiste që
2 ne të na kërkohet që të bëjmë gati dosjen ndërkohë që kemi mbi
3 18 mijë faqe dokumente që duhet t'i lexojmë dhe t'i
4 analizojmë. Do ndaloj këtu, do t'i kërkoj z. Buckley që të
5 flasë shumë shkurtimisht sepse jam në dijeni të faktit që
6 kolegët e mi duhet të ikin se duhet të ikin, se kanë për të
7 kapur avionin.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Buckley, fjala për ju.

9 Z. Buckley: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës,
10 edhe unë dua të them që afati kohor është shumë i shkurtër dhe
11 neve në fakt besoj se është e qartë që të dyja skuadrat, të
12 dyja ekipet e mbrojtjes janë të frustruar me mënyrën se si
13 është trajtuar kjo çështje deri tani nga pala tjetër.

14 ZPS-ja ka parashtruar në mënyrë të vazhdueshme që ajo nuk
15 parashikonte ndonjë volum shumë të madh materialesh,
16 megjithatë është bërë e qartë që ka vështirësi të qarta dhe ka
17 arsye për të gjithë acarimin e krijuar nga ana e mbrojtjes.

18 Më parë ZPS-ja ka kërkuar që të sugjeroje që mbrojtja po
19 kërkon të vonojë këtë çështje dhe sërish ky pozicion është
20 tërësisht i padrejtë dhe i pasaktë. Realiteti është që disa
21 gjëra të cilat duhej të kishin qenë shumë të qarta, të
22 drejtpërdrejta që në fillim fare, janë zvarritur kaq shumë me
23 qëllimin kryesor që të arrinim në këtë pikë ku kemi mbërritur
24 sot.

25 Z. Rees e tha më parë se sa përpara realizimit të

1 konferencës për ecurinë e çështjes, vetëm një ditë përpara ne
2 kemi marrë një sasi të konsiderueshme informacionesh duke
3 përfshirë një matricë të përgjithësuar prej 500 faqesh për
4 dosje dhe bëhet fjalë për 17 dosje shumë voluminoze. Pra, ne
5 kemi thuar se 18 mijë e 500 dokumente, pra faqe dokumentesh të
6 cilat na janë vënë në dispozicionin tonë dhe për këtë arsye më
7 duhet të them që numri i përgjithshëm i dokumenteve që kemi
8 për të shqyrtuar është goxha i madh.

9 Në faza të ndryshme, ZPS-ja ka thënë që detyrimet e saj
10 për të nxjerrë informacione janë të plota, dhe del e qarte
11 sot që në fakt ajo nuk e ka mbajtur fjalën e saj. Edhe një
12 herë sot ZPS-ja na ka dhënë pozicionin e vet dhe ZPS-ja nuk e
13 ka kuptuar akoma që mbrojtja ka të drejtën absolute për proces
14 të rregullt ligjor.

15 Pra, vetëm duke iu referuar nxjerrjes së fundit, rreth 18
16 mijë e 500 faqe, janë shumë material i konsiderueshëm për neve
17 për t'u shqyrtuar, ndërkohë që kemi mbi 37 mijë minuta, 16 orë
18 (sipas përkthimit) ose 88 ditë, -- 16 mijë e ca orë (sipas
19 përkthimit), apo 88 ditë të plota që duhet të vëzhgohen nga
20 materiali i regjistruar. Pra bëhet fjalë për një punë të
21 jashtëzakonshme, masive që duhet të bëhet prej nesh.

22 E vura re konstatimin e ZPS-së që dokumentet. ose të
23 gjitha faqet, -- jo të gjitha janë relevante. Megjithatë, ne
24 duhet që t'i lexojmë dhe të arrijmë në përfundim tonin, sepse
25 ka një dallim të madh ndërmjet mendimit të tyre dhe fakteve.

1 Dhe për këtë arsye mbrojtja duhet që të lexojë çdo fjalë, çdo
2 rresht të çdo faqeje për të arritur në përfundimet e veta.

3 ZPS-ja ka detyrimet zyrtare, profesionale për t'u
4 informuar të gjithë palët që janë subjekt i nxjerrjes.
5 Pavarësisht nga mendimi i ZPS-së që këto materiale një pjesë e
6 tyre nuk ndoshta nuk janë të lidhura me çështjen apo jo, ky
7 nuk është vendim që duhet ta marrin ata.

8 Po ashtu do të doja të mbështes pikat e ndritura nga z.
9 Rees sa i takon historikut procedural të kësaj çështje.
10 Sërish, edhe parashtrimet e mëparshme të ZPS-së janë të
11 padrejta, të pasakta dhe për këtë arsye jemi në një pikë ku
12 sipas mendimit tonë, çështja nuk është një pikë që është afër
13 dosjes së paraprake dhe për këtë arsye më duhet të them që
14 mund të kemi sërish materiale të tjera me një volum që ZPS-ja
15 nuk e bën të ditur prej nesh dhe që duhet të shqyrtohet prej
16 nesh.

17 Pra ZPS-ja duhet të jetë e qartë lidhur me dokumentet që
18 ata kanë në posedim dhe dokumentet që do të nxjerrin. Pra,
19 duhet që të jetë e qartë me ne në mënyrë të tillë që mund të
20 vijojmë me shpejtësi për ta trajtuar këtë çështje brenda
21 mundësive tona. Të gjitha këto pika kanë ndikim të
22 drejtpërdrejtë në mundësinë e mbrojtjes për të vijuar më tej
23 me çështjen dhe për të bërë hapat e nevojshëm paraprakë,
24 përfshi këtu edhe hetimin e dosjes paraprake.

25 Sërish, do të doja të them që afati kohor për dorëzimin e

1 dosjes paraprake sipas afatit të përcaktuar deri tani është i
2 pamundur që të përmbushet, që të respektohet dhe të gjitha
3 prezumimet ndryshe do të ishin të pasakta.

4 Sa i takon natyrës së zvarritur të procesit të nxjerrjes,
5 aftësia për të nxjerrë apo për të parashtruar kundërshtime
6 ndaj provave, sërish është e vonuar. Lista e provave është
7 nxjerrë në 9 prill dhe në fakt është nxjerrja e provave vetë
8 që përbën bazën për të informuar mbrojtjen sa i takon
9 parashtrimin të kundërshtimeve. Kështu që nuk është e saktë që
10 të prezumohet që është e disponueshme -- ka qenë e
11 disponueshme që nga data 9 prill, sepse sërish kjo në kuadër
12 të asaj çfarë thamë dhe më sipër rezulton qartazi e pasaktë.

13 Kështu që për këtë arsye do t'ju kërkonim, i nderuar
14 Gjykatës, që të përcaktonit një afat kohor realist dhe ne
15 njohim gjithashtu edhe detyrimet për të trajtuar çështjet në
16 mënyrë të shpejtë dhe për të siguruar që çështja vijon siç ajo
17 duhet të vijojë dhe mbrojtja duhet që të respektojë detyrimet
18 e saj dhe duhet që të vijojmë me progresin e natyrshëm në këtë
19 çështje.

20 I nderuar Gjykatës, mund të flas pafund lidhur me këtë
21 temë, megjithatë për shkak të faktit që kemi kohë të kufizuar,
22 dua ta përfundoj këtu.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit Z. Guillou
24 (sipas përkthimit) - tani -- z. Buckley. Tani fjala për ZPS-në.
25 Nuk e di nëse mund të trajtoni temën e videove.

1 Znj. BOLICI: [Përkthim] Po, faleminderit, i nderuar
2 Gjykatës. Dua të trajtoj pretendimet e mbrojtjes shumë
3 shkurtimisht.

4 E kuptoj që mbrojtja kërkon shtyrjen e afatit kohor për
5 dosjen paraprake. Një gjë të tillë ata mund ta bëjnë duke
6 treguar arsye të qenësishme, por nuk mund ta bëjnë duke
7 keqpërfaqësuar historikun procedural të çështjes, por nuk dua
8 t'i futem këtij diskutimi, por të them që ZPS-ja ka respektuar
9 të gjitha pikat dhe të gjitha afatet kohore si dhe ka
10 parashikuar dhe ka ngritur paraprakisht çështjet si me palët
11 ashtu edhe me Gjykatën.

12 Sa i takon komentit të fundit të mbrojtjes të z.
13 Haradinajt, po, të gjitha materialet të cilat janë treguar në
14 listën e provave, pra janë nxjerrë përpara depozitimit të
15 listës së provave dhe nuk është një çështje e cila duhet të
16 diskutohet tani.

17 Tani, më lejoni t'i kthehem pak çështjes së regjistrimit
18 në video dhe sa i takon kontrollit të sekuestrimit.

19 Në përputhje me urdhrin tuaj, i nderuar Zoti Gjykatës, ne
20 jemi angazhuar me mbrojtjen e z. Gucati për të bërë parjen e
21 parë të këtyre videove dhe në momentin kur ishin ngarkuar
22 videot në laptop, atëherë pamë që të 11 dokumentet të cilat
23 janë listuar sipas njoftimi të rregullës 102(3), në fakt janë
24 pjesë të ndryshme të videove, nuk janë përsëritje të njëra-
25 tjetrës.

1 Pra, të njëjtat video janë lidhur disa herë me ERN të
2 ndryshme, të 11 videot i janë bërë të disponueshme mbrojtjes
3 së Z=z. Gucati, siç është specifikuar në vendimin e kohëve të
4 fundit tuajin, i nderuar Z. Gjykatës. Jemi në procesin e
5 përfundimit të paketës së plotë të videove për Gjykatën të
6 cilën synojmë -- të cilën proces synojmë ta përfundojmë sot.

7 Mbrojtja për Haradinajn ka thënë që synojnë që të shohin
8 videot të hënën dhe janë bërë organizime të ndryshme që në
9 qoftë se mbrojtja për Z. Gucati dëshiron që t'i shikojë
10 videot, atëherë do të bëjmë edhe përgatitje të tjera në mënyrë
11 që të bëhemi gati për këtë gjë. Ky është fundi i parashtrimeve
12 të mia në lidhje me këtë pikë.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit prokurores.

14 Z. Rees, keni diçka?

15 Z. REES: [Përkthim] Jo, nuk kam asgjë.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] z. Cadman?

17 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes video lidhjes] Vetëm sa për
18 të ritheksuar që ne mund të paraqesim edhe një parashtrim me
19 shkrim për këtë, por pozicioni jonë është krejtësisht e
20 papërshtatshme që ne t'i shikojmë këto video pa pasur klientët
21 aty dhe pa marrë udhëzimet e plota prej tyre. Pra kjo lidhet
22 edhe me urdhrin tuaj të kaluar, i nderuar Gjykatës dhe ne
23 marrim të gjitha hapat e nevojshme në lidhje me këtë. Por ne
24 është e pamundur të marrim udhëzime nga klientët tanë nëse nuk
25 e shikonim materialin filmik dhe nuk e kuptoj se pse

1 mbrojtësit që janë anëtarë të Dhomës së Avokatëve së Anglisë
2 dhe të Uellsit, nuk mund të shikojnë këto video.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Kemi marrë vendim për këtë
4 çështje. Ose bëni një kërkesë rishqyrtim të vendimit ose bëni
5 kërkesë për apel. Një nga këto të dyja.

6 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes video lidhjes] Kemi ndërmend
7 ta bëjmë këtë.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.
9 Znj. prokurore keni diçka?

10 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Jo.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani do të kalojmë te pika
12 tjetër e çështjes së -- e rendit të ditës që janë për çështjet
13 për të cilat është rënë në pajtim lidhjet faktike apo ligjore.
14 Prokuroria [i ka] komunikuar mbrojtjes se një propozim për
15 faktet për të cilat është rënë në pajtim por nuk është dhënë
16 përgjigje për këtë. Si të dyja ekipet -- të dyja ekipet e
17 mbrojtjes na thanë që nuk do të jenë në gjendje që të japin
18 mendimet e tyre për sa i përket pikave të pajtimit për
19 çështjeve faktike dhe ligjore përpara se të dorëzohet dosja
20 paraprake nga ana e tyre. A keni diçka për të shtuar në lidhje
21 me këtë temë -- i nderuar Gjykatës -- e nderuar Prokurore?

22 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Jo.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Rees?

24 Z. REES: [Përkthim]

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Cadman?

1 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes video lidhjes] Jo, nuk kam
2 gjë për të shtuar.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit Z. Cadman,
4 tani kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës, që janë
5 hetimet e mbrojtjes.

6 Ftoj mbrojtjen të na përditësojë në lidhje me gjendjen e
7 hetimeve të tyre, duke na dhënë edhe një sasi të përgjithshme
8 për provat që do të japin, llojin e provave që do të japin.

9 Unë kam parë që mbrojtja nuk ka ndërmend të ofrojë
10 mbrojtje përmes alibisë. Po kështu ata nuk kanë një pozicion
11 përfundimtar në lidhje me arsyet për përjashtimin e
12 përgjegjësisë dhe nuk mund të thonë asnjë përgjigje as
13 pozitive, as negative në lidhje me mbrojtjen. Po kështu në
14 lidhje me masat mbrojtëse, masat e veçanta hetimore, asgjë nuk
15 është parashikuar edhe në lidhje edhe me këtë. Tani ftoj
16 mbrojtën që na thotë pozicionin -- të na thonë pozicionin e
17 tyre në lidhje me këtë çështje, megjithëse këto janë paraqitur
18 në parashtrimet e tyre me shkrim, po nuk e di nëse keni diçka
19 për të shtuar? Z. Rees?

20 Z. REES: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës, nuk kam asgjë
21 tjetër për të shtuar përveç atyre që kam parashtruar me
22 shkrim.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Cadman?

24 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes video lidhjes] Edhe unë jam
25 në të njëjtin pozicion, nuk kam asgjë për të shtuar.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ka Prokuroria diçka për të
2 thënë për këtë?

3 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Falemnderit, i nderuar Gjykatës,
4 vetëm një sqarim në lidhje me parashtrimet e mbrojtjes në
5 lidhje me arsyet e tjera përveç.. arsyet e tjera që
6 përjashtojnë përgjegjësinë penale sipas rregullës 95(5), sepse
7 në kalendarin përmbledhës u përcaktua që do të dorëzoheshin
8 këto në datën 11 maj, por pastaj s'kemi dëgjuar më. Vetëm
9 thjeshtë për sqarim, ndërsa mbrojtja do të paraqesë këtë deri
10 në 11 maj apo do të bëjë kërkesë për të shtyrë afatin, sepse
11 nuk e përmbush dot këtë afat.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mesa kuptoj unë, mbrojtja
13 nuk është në gjendje ta bëjë këtë, pavarësisht nga afati që u
14 caktua, duke pasur parasysh çështjet e nxjerrjes së
15 informacionit që ka ngritur z. Rees dhe mbrojtja në
16 përgjithësi. Z. Rees?

17 Z. REES: [Përkthim] Po, ashtu është. Unë mund t'ju flas i
18 nderuar Gjykatës se si funksionon rregulla 95 dhe ka një
19 dallim midis ofrimit vullnetar nga mbrojtja për dorëzimin e
20 dosjes paraprake dhe kërkesës së detyruar për të dhënë
21 njoftime për mbrojtjet e caktuara që do të argumentohen dhe do
22 të do të paraqiten në rrethanat të asaj që ne kemi thënë që në
23 fillim që ne kemi ndërmend të dorëzojmë një dosje paraprake
24 vullnetare dhe mbrojtja jonë do të -- dhe mbrojtja jonë -- dhe
25 kjo dosje do të përfshijë edhe njoftimin e argumenteve të

1 mbrojtjes.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Cadman?

3 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes video lidhjes] Dua vetëm të
4 shtoj, që siç -- atë që kam thënë në parashtrimet e mia me
5 shkrim, se çdo argument i mbrojtjes do të paraqitet në dosjen
6 paraprake.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Z. Cadman,
8 tani ne lidhje me datën ardhshme të Konferencës së ardhshme
9 për Ecurinë e Çështjes. Znj. Bolici?

10 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ne jemi dakord që të bëhet edhe
11 një konferencë tjetër për ecurinë e çështjes dhe do të ishte
12 me dobi që ta bënim atë konferencë para se -- pasi të jetë
13 dorëzuar dosja paraprake e mbrojtjes.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Rees?

15 Z. REES: [Përkthim] Unë i kam paraqitur propozimet e mia
16 për afatet kohore, po duke pranuar që këto afate nuk do të
17 mund të përmbushen për arsye të ndryshme. Ju mund të vendosni,
18 i nderuar Gjykatës, në lidhje me këtë.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Cadman?

20 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes video lidhjes] Unë i dëgjova
21 propozimet e z. Rees në lidhje me afatet dhe e mbështes atë.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani dua t'i pyes palët
23 nëse duan të ngrenë ndonjë çështje tjetër. Prokurorja?

24 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të shtuar nga
25 ana e Prokurorisë.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Rees?

2 Z. REES: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të shtuar.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Cadman?

4 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes video lidhjes] Në interes të
5 kohës nuk po shtoj asgjë, i nderuar Gjykatës.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë me kaq mbyllet
7 seanca e sotme. Falënderoj teknikët, përkthyesit, personelin e
8 sigurisë dhe gjithë pjesëmarrësit dhe do të takohemi përsëri
9 për Konferencën tjetër të Statusit kur të caktohet data. Me
10 kaq mbyllet seanca.

11 SEKRETARI I SEANCËS: Të gjithë në këmbë.

12 --- Konferenca e Ecurisë së Procedurës u
13 mbyll në orën 13:47

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25